

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ELVIN GOKAJ

07/24/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 22.07.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Elvin Gokaj, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 24.07.2019, me shumicë votash vendosi:

Pezullimin nga detyra për një periudhë 1-vjeçare të subjektit të rivlerësimit, Elvin Gokaj, prokuror/ drejtues në Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe detyrimin e tij për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese e kryesuar nga znj. Xhensila Pine, znj. Genta Tafa Bungo relatores, znj. Pamela Qirko anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.